



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:040547
Datë: 07.11.2023
Numri i dokumentit: 04882737

PAKR.nr.400/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Beqir Kalludra, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Albulena Rexha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve, L.K., nga Prishtina dhe A.K., nga Malisheva, për shkak të veprës penale se në vazhdimësi dhe bashkëkryerje kanë kryer veprën penale ushtrim i ndikimit, nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, i akuzuari A.K., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve sipas nenit 390 par.2 lidhur me par.1 të KPK, të akuzuarit L.K. dhe A.K., në bashkëkryerje për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, i akuzuari L.K. dhe F.D., nga Prishtina, në bashkëkryerje për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, i akuzuari L.K., për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 të KPK, dhe të akuzuarës M.B., nga Prishtina, për shkak të veprave penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPK dhe blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale, sipas nenit 333 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mbrojtësve së të akuzuarve, L.K., av.Ramë Gashi, A.K., av.Nysret Mjeku, dhe M.B., av.Fatlum Podvorica, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.484/2021, të dt.25.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesave, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si dhe të mbrojtësve së të akuzuarve, L.K., av.Ramë Gashi, A.K., av.Nysret Mjeku, dhe M.B., av.Fatlum Podvorica, e sipas detyrës zyrtare anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për

Krime të Rënda, PKR.nr.484/2021, të dt.25.04.2023, ashtu që çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

I.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.484/2021, të dt.25.04.2023, janë liruar nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar:

- të akuzuarit L.K. dhe A.K., për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK,

-i akuzuari L.K., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK,

-të akuzuarit: L.K. dhe F.D., për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje, nga neni 414 par.1, lidhur me nenin 31 të KPK,

-e akuzuara M.B., për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale sipas nenit 333, par.1 të KPK.

II.

Të akuzuarit:

- M.B., është shpallur fajtores për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve sipas neni 390 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 5.000 (pesëmijë) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të cilin dënim të shqiptuar me gjobë, i është llogaritur koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak, prej dt.01.03.2021 deri me dt.31.03.2021.

-L.K., për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 430 par.2 të KPK, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 8.000 (tetëmijë) Euro, dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, është zëvendësuar në dënimin me gjobë në shumën prej 6.000 (gjashtëmijë) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit L.K., në dënimin e shqiptuar me gjobë i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.01.03.2021, gjerë me dt.30.03.2021, dhe arresti shtëpiak nga dt.30.03.2021, gjerë me dt.29.07.2021.

-A.K., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, sipas nenit 390 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.1 të KPK, ashtu që për veprën e parë penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 par.1 të KPK, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) Euro, kurse për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par.1 të KPK, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 5.000 (pesëmijë) Euro.

Në kuptim të nenit 76 par.1 lidhur me par.2 pika 2.2 dhe 2.4 të KPPK, të akuzuarit A.K., i është shqiptuar dënimi me burgim unik në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 6.000 (gjashtëmijë) Euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve.

Në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.03.03.2021, gjerë me dt.30.03.2021, si dhe prej dt.05.05.2021, gjerë me dt.29.07.2021, e po ashtu edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga dt.30.03.2021, gjerë me dt.05.05.2021.

Të akuzuarit A.K., në kuptim të nenit 62 i është shqiptuar dënimi plotësues, ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike, në administratën publike ose shërbimin publik, në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, pas ekzekutimit të dënimin.

Urdhërohet që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, vetura e sekuestruar e tipit “VWT-roc”, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit 01-706 NQ, të i kthehet pronares M.B..

Janë obliguar të akuzuarit që t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, detyrohen që t’i paguajnë shpenzimet dhe atë, secili veç e veç, shumën prej 200 (dyqind) Euro, si dhe në emër të fundit për kompensimin e viktimave të krimit, gjithsecili veç e veç shumën prej 50 Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me seksionin penal, konfiskimit dhe kërkesave juridike, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje,

-mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje,

-mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av.Nysret Mjeku, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, si dhe

-mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me seksionet penale, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe e akuzuara M.B., të lirohet nga akuza, apo sa i përket pikës II të aktgjykimit për veprën penale për të cilën e njëjta është shpallur fajtores, aktgjykimi të anulohet dhe çështja penale ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje.

Përgjigje në ankesë të prokurorisë, kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, duke propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa ka ngelur pranë pretendimeve ankimore sipas ankesës së ushtruar,

-mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, ka ushtruar përgjigje në ankesë të prokurorisë, duke propozuar që e njëjtë të refuzohet si e pabazuar, si dhe

-mbrojtësi i të akuzuarës F.D., av.Arlind Jupolli, ka ushtruar përgjigje në ankesë të prokurorisë, duke propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar, sepse në këtë çështje penale, nuk është ofruar asnjë provë e re apo rrethanë e re dhe se procesi i zhvilluar gjyqësor, sikurse është vërtetuar me aktgjykim lirues, është i drejtë sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që të vërtetoj figurën e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarës, dhe propozon që në drejtim të së njëjtës të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.369/2023, të dt.11.07.2023, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar, që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, kurse sa i përket ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, M.B., av.Fatlum Podvorica, L.K., av.Ramë Gashi, A.K., av.Nysret Mjeku, dhe përgjigjeve në ankesë të prokurorisë, mbrojtësve të akuzuarve M.B., av.Fatlum Podvorica, L.K., av.Ramë Gashi dhe F.D., av.Arlind Jupolli, të refuzohen si të pabazuara.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.17.10.2023, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, i akuzuari L.K., së bashku me mbrojtësi e tij, av.Ramë Gashi, mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av.Nysret Mjeku, e akuzuara M.B., dhe mbrojtësi i saj, av.Fatlum Podvorica, e akuzuara F.D. dhe mbrojtësi i saj, av.Arlind Jupolli, ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, i dëmtuari B.M. dhe i akuzuari A.K., edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt, apo nëpërmes mbrojtësve të tyre.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, propozon që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, dhe për pjesën liruese aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, kurse sa i përket pjesës dënuese të akuzuarit L.K., për veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, nga neni 430 par.2 të KPK, të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

I akuzuari L.K., deklaron se mbetet pranë deklarimeve të mbrojtësit të tij, duke e përkrah ankesën e ushtruar, si dhe përgjigjen në ankesë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K., av.Nysret Mjeku, deklaron se mbetet pranë ankesës së ushtruar, dhe propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza, që nënkupton që për këtë pjesë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, kurse sa i përket ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar, duke propozuar që për pjesën liruese aktgjykimi të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, deklaron se ngel pranë ankesës së ushtruar, propozon që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, ashtu që aktgjykimi për pjesën liruese të vërtetohet, ndërsa sa i përket pjesës dënuese të ndryshohet dhe e akuzuara M.B., të lirohet nga akuza.

E akuzuara M.B., deklaron se pajtohet me fjalët dhe ankesën e ushtruar, si dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të saj.

Mbrojtësi i të akuzuarës F.D., av.Arlind Jupolli, ka deklaruar se ngel pranë përgjigjes në ankesë dhe propozon që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

E akuzuara F.D., deklaron se e mbështet deklarinimin e mbrojtësit të saj, duke theksuar se nuk ka çka të shtoj më shumë.

Kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ka ushtruar Prokuroria Themelore, të cilat shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 269 par.1 të KPK, duke pretenduar se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nuk janë dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimin, sikurse parashihet në të njëjtën, sepse edhe në momentin e konfiskimit të pasurisë, nuk është precizuar në mënyrë të qartë dhe të plotë se si është bërë konfiskimi. Prokuroria ka propozuar që ti bëhet konfiskimi i veturës VWT-roc, me ngjyrë të bardhë, në pronësi të akuzuarës M.B., në kuptim të nenit 115 par.2 të KPPK, e njëjta ka qenë objekt hetimi, ashtu që pasi që është shpallur fajtores e akuzuara për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 par.1 të KPK, i cili dokument – deklaratë është përpiluar me dt.16.12.2019, në zyrën e saj në KPK, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti, e nënshkruar edhe nga ana e shitësit, e akuzuara pretendon se e ka blerë të njëjtin për 8.400 Euro, ashtu që në zyrën e noterit S.B., në Prishtinë, kanë bërë kontratën, e po ashtu janë dakorduar që të paguhet edhe dënimet e të njëjtës në vlerë prej 600 Euro, ashtu që është vendosur në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore nga ana e gjykatës, që automjeti i lartë theksuar ti kthehet pronares M.B., ashtu që këtu lindin kundërshtime që kanë të bëjnë edhe me falsifikimin e dokumentit. Sa i përket konfiskimit kjo masë është e karakterit preventiv, e po ashtu edhe dobia pasurore e krijuar nga kjo çështje juridike është e pa justifikueshme, që nënkupton se në këtë çështje penale janë bërë shumë parregullsi.

Po ashtu ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, është dashur që të ketë parasysh se i mbrojturi i tij L.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave i dobisë tjetër materiale, ose detyrimeve financiare, mirëpo rezulton se gjykata e shkallës së parë, përkundër asaj që ka pasur obligim ligjor që për këtë veprë penale para se të vendos që të akuzuarin ta shpallë fajtor, të vërtetoj të gjitha hyrjet daljet, në pasurinë e këtu të akuzuarit L.K., për të ardhur në përfundim se i njëjti është kryes i veprës penale apo jo. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në masë të duhur të gjitha shkeljet që përfshihen në këtë aktgjykim se sidomos i njëjti përfshihet me shkeljet nga neni 369 par.4, 6 dhe 7 të KPPK, dhe lidhur me nenin 364 par.1 dhe 2 të KPPK.

Gjykata e shkallës së parë, është dashur që të paraqet arsye për çdo pikë të aktgjykimin, dhe në mënyrë të qartë dhe të plotë të qartëson se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, e po ashtu në mënyrë të qartë dhe të plotë, të vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse dhe të jep arsye lidhur me mos miratimin apo miratimin e propozimeve konkrete të palëve. Gjykata është dashur që për veprën penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari, të paraqes fakte dhe rrethana të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KPK. Është me rëndësi që dispozitat ligjore përkitazi me emërtimin ligjor të veprës penale të jenë të paraqitura në dispozitiv të aktgjykimin. Nga kjo rezulton se nuk është përfshirë shuma e të hollave prej 40.000Euro, të cilën i akuzuari e ka pranuar nga F.A., e cila është paraqitur, por pa dhënë ndonjë shpjegim se si ka shkuar rrjedhja e kësaj shume, për të vërtetuar që e njëjta a bie ndesh me dispozitën ligjore, nga neni 5 i ligjit për deklarimin e pasurisë, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Edhe dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar, nuk është i qartë, dhe ka kundërshtime, e sidomos në tog faleshin, 40.000 Euro, të cilat i ka pranuar nga F.A., nuk janë sqaruar, sepse të njëjta janë nga banesa, e cila më parë është deklaruar, të cilët e bëjnë dispozitivin e aktgjykimit të pa qartë dhe të pa kuptueshëm. Sa i përket deklarimit lidhur me gjendjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe anëtarëve të familjes së tyre, duhet pasur informacione rreth pasurisë, përkitazi me pa luajtshmërinë, vlerën e pa luajtshmërisë që në rastin konkret është 5.000 Euro, zotërimin nga ana e tyre të aksioneve në shoqëri tregtare, letra me vlerë, para të kursyera në banka dhe në institucione të tjera financiare, detyrimet financiare ndaj personave fizik dhe juridik dhe të hyrat vjetore, të cilat është dashur që të qartësohen se nga kanë ardhur. Po ashtu gjykata e shkallës së parë, është dashur që të jep arsye lidhur me përshkrimin e mjeteve të pranuar, ashtu që në këtë aktgjykim nuk janë dhënë arsye të drejtpërdrejta dhe mungon elementi subjektiv në kryerjen e veprës penale, sikurse edhe elementi objektiv të cilat çështje pasi që nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, atëherë edhe e bëjnë aktgjykimin të pa qartë dhe të pa kuptueshëm.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 370 par.6 të KPPK, sepse nuk janë paraqitur fakte të qarta dhe të plota, për të dhënë arsye se cilat ndërlidhen me dokumente kinse të falsifikuara dhe atë deklaratën e dt.16.12.2019, që sipas aktakuzës akuzohet e akuzuara. E po ashtu gjykata e shkallës së parë, me diapozitivin e aktgjykimit sipas të cilit e akuzuara është shpallur fajtores, rezulton se i njëjti është në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e dhëna lidhur me këtë çështje penale dhe si i tillë aktgjykimi është i pa qartë dhe i pa kuptueshëm.

Nuk janë vlerësuar raportet e Agjensionit të Kosovës për Forenzikë, me nr.AKF/2021-850, të dt.21.04.2021, nuk ka konstatuar se të njëjtën e ka nënshkruar e mbrojtura, tek emri i dëshmitarit B.M., ashtu që nuk mund të flitet për veprën penale të falsifikimit të dokumentit.

Edhe sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit A.K., av. Nysret Mjeku, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të qarta dhe të plota për çdo pike të aktgjykimit, për të qartësuar se i akuzuari A.K., qoftë në pozitën e vozitësit apo personit zyrtar, a ka mundur ti ndërmarrë këto veprime, se a ka pasur përgatitje profesionale, për të kryer falsifikim të dokumenteve zyrtare, andaj edhe i njëjti është dashur që të lirohet për të njëjtën.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, si dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit A.K., av.Nysret Mjeku, aktgjykimit të ankimuar si dhe shkresave të tjera, të lëndës, ka ardhur në përfundim se i njëjti përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten, si dhe me arsyet e dhëna lidhur me secilën veprë penale e cila i vihet në barrë secilit të akuzuar, ngase nuk përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat i karakterizojnë veprat penale të përshkruara sikurse

në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, sipas të cilit të akuzuarit L.K. dhe A.K., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale ushtrimi i ndikimit në vazhdimësi dhe bashkëkryerje, nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, i akuzuari L.K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, të akuzuarit L.K. dhe F.D., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar, si bashkë kryes, nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, e akuzuara M.B., për shkak të veprës penale blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, për të cilat vepra penale që të gjithë të akuzuarit në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, janë liruar nga akuza, sepse nuk është provuar që kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar. Nga arsyetimi i dhënë për këto vepra penale për të cilat të akuzuarit janë liruar nga akuza, gjykata e shkallës së parë, pretendon se i ka shtjerrë të gjitha mundësitë që të vërtetoj se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, mirëpo kolegji i kësaj gjykate i vlerëson që të gjitha dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve L.K. e A.K., përkitazi me veprën penale ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të vërtetojë se nga pozita të cilën e ka pasur këtu i akuzuari L.K., cili ka qenë veprimi apo ndikimi i tij, në të akuzuarin A.K., të cilin e ka pasur shofer personal. Po ashtu nuk ka arritur që të qartësoj raportin në mes të tij dhe A.K.t, përkitazi me dëshmitarin – bashkëpunues B.M., sepse të gjitha veprimet e ndërmarra kanë shkuar nëpërmes të A.K., i cili sikurse theksohet disa herë ka pranuar të holla, duke arritur shifrën për 40.000 Euro, rrethanë e cila është me rëndësi për tu vërtetuar, ngase është element konstituiv i veprës penale, e cila i vihet në barrë secilit të akuzuar. Po ashtu edhe në veprimet e të akuzuarit L.K., për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, gjykata e shkallës së parë është dashur që të identifikoj rolin e të akuzuarit L.K., i cili ka qenë drejtor në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke e pasur pozitën personal të akuzuarin A.K., dhe cilat veprime i njëjti i ka marrë me të dëmtuarin – bashkëpunuesin B.M., që të arratiset për në Republikën e Shqipërisë, cili ka qenë veprimi i marrë nga ana e të akuzuarit L.K., kurse sa i përket të akuzuarit A.K., që i ka ndërmarrë për të kaluar kufirin A.M.t, për të shkuar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që ti shmanget veprimeve ligjore që është dashur të ndërmerren në drejtim të tij.

Sa i përket veprës penale në drejtim të akuzuarit L.K. dhe të akuzuarës F.D., gjykata e shkallës së parë është dashur që të vlerësoj dhe të vërtetoj se në këtë çështje penale a kemi të bëjmë me veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe të qartësoj me ndihmën e njëjtë, ekspertit përkatës se cilat veprime është dashur të ndërmerren, dhe pse është bërë shfrytëzimi i operatorit tjetër ekonomik, i cili nuk e ka fituar tenderin në këtë çështje penale për të pajisur kabinetin e kryesuesit të KPK. Në vijimësi rezulton se e akuzuara M.B., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, sipas nenit 333 par.1 të KPK, dhe nuk janë dhënë arsye të qarta dhe të plota në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, se si ka rrjedh procedura deri te pajisja me nënshkrime që e akuzuara M.B., të bëhet pronare e automjetit, e po ashtu nuk janë dhënë arsye se a janë shfrytëzuar të gjitha rrethanat e pajisjes me automjet, këtu të akuzuarës M.

Kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara në nenin 384 të KPPK, sepse e njëjta gjykatë është e obliguar që të vërtetoj se për cilën veprë penale secili i akuzuar është shpallur fajtor, që është edhe obligim ligjor i paraparë në nenin 364 lidhur me nenin 363 përkitazi me aktgjykimin lirues apo dënues, kurse në rastin konkret në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, ka marrë aktgjykim lirues, duke e arsyetuar të njëjtin se nuk është provuar që të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Sa i përket aktgjykimit dënues, i cili nxjerrët në kuptim të nenit 364 par.1 të KPPK, gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e nxjerrë në raport me të akuzuarit A.K., L.K., dhe M.B., nuk i ka vërtetuar të gjitha elementet e ekzistimit të veprës penale, për të cilën secili i akuzuar është akuzuar dhe është shpallur fajtor, sepse nuk e ka vërtetuar figurën e veprës penale dhe rrethanat të cilat e përbëjnë figurën e së njëjtës, e po ashtu nuk ka vërtetuar se cilat fakte apo cilat rrethana nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të ligjit penal, të jepen sqarime më konkrete. Po ashtu edhe te vendimi për konfiskimi i pasurisë së specifikuar nuk janë dhëna arsye të qartë edhe të plotë lidhur me ekzistimin e kësaj vepre penale.

Kolegji pasi që ka vlerësuar aktgjykimin si tërësi ka ardhur në përfundim që i njëjti përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase sipas ankesave të ushtruara, nga ana e prokurorisë, mbrojtësit së të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, mbrojtësit së të akuzuarit A.K., av.Nysret Mjeku, përkundër asaj që aktgjykimi është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, rezulton se pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, po ashtu përfshihet edhe me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe atë sikurse në pikën I, po ashtu edhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, sepse me provat të cilat janë vlerësuar, e sidomos nga vlerësimi i deklaratave së të akuzuarve, e po ashtu edhe dëshmitarëve nga shkresat e lendes, sikurse janë dëshmitarët, duke filluar nga dëshmitari bashkëpunues B.M., i cili në mënyrë të qartë ka bërë përshkrimin e veprimeve të ndërmarra nga ana e vet, e po ashtu edhe në raport me të akuzuarin A.K., L.K., dhe me të akuzuarën M., ka bërë përshkrimin e veprimeve të ndërmarra sikurse janë të paraqitur në arsyetim të aktgjykimit, mirëpo, pa dhënë ndonjë arsyetim më të qartë lidhur me veprimin konkretizues, i cili e karakterizon secilin të akuzuar, për secilën veprë penale, përkundër asaj që ka bërë përshkrimin e veprimeve të ndërmarra, nga ana e secilit prej tyre. I njëjti ka deklaruar se është e pa kontestueshme që A.K., ka kërkuar të holla me qëllim që të ndërmer veprime lidhur me lëndët të cilët i kanë në gjykatë, dhe se i njëjti ka qenë si udhë lidhëse me L.K.n, të cilët kanë kërkuar shumë të hollave dhe atë i akuzuari A, me qëllim që i akuzuari L, ti kryej punë në gjykatë, dhe kanë ekspozuar takime në vende të ndryshme, sikurse është restoranti “Gizi”. Në restorant rezulton se kanë qenë Ai, Li dhe M., ashtu që flitet për shumë të të hollave, e po ashtu të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e këtu të akuzuarve, ndërldihen edhe me deklaratat e dëshmitarëve A.M., B.P., B.B., noterin S.B., i cili ka deklaruar se në zyrën e tij, është bërë deklarata lidhur me automjetin përkatësisht kontratën për shitblerjen e veturës të WT-roc, me nr.LRP..., mirëpo nuk i kujtohet në tërësi deklarata dhe se sipas kontratës rezulton se shitës është Entiteti Hysi, SHPK, të cilën e përfaqëson B.M., kurse blerës është M.B.. Po ashtu edhe nga vlerësimi i deklaratës së dëshmitarëve, E.Sh., L.D., V.C., I.H., F.K., D.B.,

I.S., Z.K., F.L., F.S., B.L., që të gjitha këto deklarata, janë të ndërlidhura lidhur me veprat penale të cilat janë kryer nga ana e të akuzuarve, dhe sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ekziston që është bërë punimi i të njëjtit në dy pika, në pikën e I, që ndërlidhet me aktgjykim lirues dhe në pikën e II me aktgjykim dënues, dhe atë në drejtim të të akuzuarve A.K., për veprat penale të përshkruara më për së afërmi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, për veprën penale në drejtim të akuzuarit L.K., si dhe të akuzuarës M.B..

Se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, rezulton se me të gjitha provat personale si dhe provat materiale, sikurse janë kontrata e shitblerjes së veturës LRP-16008/12, REF.3464/19, e dt.16.12.2019, e lidhur në mes të akuzuarës M.B., në cilësinë e blerësit dhe B.M., në cilësinë e shitësit, autorizimit për përdorim të automjetit nga i cili rezulton se B.M., është i autorizuar që të shes veturën foslfagen XH, pronë e kompanisë të “....., SHPK”, marrëveshja mbi kredinë për personat fizik, nr.261060, e dt.12.12.2019, nga e cila vërtetohet se e akuzuara M.B., në cilësinë e kredi marrëses dhe H.B. në cilësinë e bashkëkredi marrëses kanë marrë nga TEB Sha. në cilësinë e kredi marrësit shumë prej 17.000 Euro, me periudhë të maturimit 84 muaj, me arsyetim për renovim dhe blerje të veturës, urdhër pagesa kombëtare ref.940273 e dt.16.12.2019, lidhur me transaksionet financiare, fletëpagesat e dënimeve të shqiptuara kundër I.S., si pronar i automjetit – dënimet me gjobë, marrëveshjes për kredinë, si dhe provave të tjera, sikurse është raporti informues i policisë, ekspertizat financiar, formularin për deklarimin e pasurisë i dorëzuar në agjencinë kundër korrupsionit në emër të L.K., me dt.31.03.2021, që të gjitha këto prova qojnë në drejtim të saj se në këtë çështje penale nuk janë respektuar të gjitha procedurat të cilat kërkohen për çdo veprim të ndërmarrë e po ashtu nuk janë vërtetuar elementet qenësore të veprave penale për të cilat të akuzuarit janë liruar, kurse në pjesën hyrëse janë shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit. Të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e secilit të akuzuar, nuk janë sqaruar në masë të duhur nga ana e gjykatës së shkallës së parë, andaj si rezultat i veprimeve të ndërmarra, ka rezultuar se në këtë çështje penale pasi që ka qenë koha e pandemisë, edhe raporti i ekzaminimit mikrobiologjik, test COVID, ID753.131, i dt.19.08.2020, testi sars Covid, me të dhënat e B.M.t, i dërguar të njëjtit me qëllim që të udhëton jashtë nuk ka qenë origjinal, ashtu që pasi që nuk ka figuruar se është lëshuar nga Instituti Mikrobiologjik i IPSHK, përkatësisht nga dëshmia e dëshmitares Z.K.D., është vërtetuar se nënshkrimi në këtë raport nuk është i saj dhe se raporti është falsifikuar, andaj i është mundësuar dëshmitarit bashkëpunues B.M., që të përdoret si i vërtet. Edhe sa i përket veprave penale të tjera, të cilat kanë të bëjnë me secilin të akuzuar, A.K., L.K., F.D. dhe M.B., ekziston mendimi nga ana e këtij kolegji dhe bindja se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar në masë të duhur elementet e veprave penale që u vihen në barë dhe si tërësi aktgjykimi duhet të anulohet.

Edhe sa i përket shkeljeve të ligjit penal, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar, nga ana e av.Ramë Gashi, av.Fatlum Podvorica, nga të cilat ankesa pretendohet se në këtë çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj si rezultat i shkeljeve të njëjtave, aktgjykimi përfshihet edhe me shkeljet e ligjit penal, sepse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit L.K., av.Ramë Gashi, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar elementet konstituive të veprës penale mos raportimi apo raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose

detyrimeve financiare, nga neni 430 par.2 të KPK, kurse sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës M.B., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 par.1 të KPK dhe veprës penale blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara në kryerjen e veprës penale, nga neni 333 par.1 të KPK, të cilat vepra penale fare mirë dihet që duhet vërtetuar sepse secila prej tyre ka elemente karakterizuese, andaj në këtë drejtim nuk është vërtetuar se në veprimet e të mbajturve të tyre, janë formuluar elementet inkriminuese për secilën vepër penale dhe kanë propozuar që të lirohen nga akuza.

Kolegji i kësaj gjykate ka bërë vlerësimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve L.K., av.Ramë Gashi dhe M.B., av.Fatlum Podvorica, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, të parapara në neni 385 të KPPK, sepse veprat penale për të cilat të akuzuarit janë akuzuar, përfshihen në ligjin penal të aplikueshëm, se nuk ka gjetur baza që të akuzuarit të përjashtohen nga përgjegjësia penale dhe ndjeka penale, se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore.

Edhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit dhe kërkesave pasurore juridike, është ankimuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës së prokurorisë, dhe sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve, av.Ramë Gashi, për të akuzuarin L.K., av.Fatlum Podvorica, për të akuzuarën M.B., dhe av.Nysret Mjeku, për të akuzuarin A.K., duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka nxjerrë vendim të drejtë për pjesën për të cilën i ka shpallur fajtor, mirëpo është potencuar, e sidomos nga ana e prokurorisë, që kjo çështje duhet të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim e vendosje, sikurse është propozuar edhe nga ana e av.Ramë Gashi, që për të akuzuarin L.K., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i mbrojturi i tij, të lirohet nga akuza, ose që të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje, sikurse që është propozuar edhe nga ana e mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av.Fatlum Podvorica, që e njëjta të lirohet nga akuza, për shkak të veprave penale për të cilat është shpallur fajtor.

Po ashtu edhe av.Nysret Mjeku, ka kërkuar që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate, pasi që ka vlerësuar si tërësi çështjen penale dhe duke iu referuar pretendime ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e prokurorisë, si dhe ankesat nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, ka vendosur që çështjen penale ta anulon për të gjitha pikat e aktgjykimit dhe të njëjtin t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Gjykata e shkallës së parë pas marrjes së këtij aktgjykimi duhet të veproj në atë mënyrë që çështjen penale ta ri caktoj, të procedoj me provat të cilat janë propozuar nga ana e prokurorisë, si dhe provat e nxjerra gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, dhe të ndërmerr veprimet që të vërtetoj që në veprimet e të akuzuarit L.K. dhe A.K., a është kryer vepra penale ushtrimi i ndikimit, nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, si bashkë kryes, duke pasur parasysh që bashkëkryerja është institut në të drejtën penale, kurse veprimet e ndërmarra a ka në

qenë në vazhdimësi, nga ana e cilit të akuzuar, cili ka qenë roli i të akuzuarit L, dhe cili ka qenë roli i të akuzuarit A, për të kryer këtë veprë penale, gjithnjë duke pasur parasysh pozitën e të akuzuarit L.K., si drejtor në Sekretariatën e KPK, pastaj i cili ka qenë roli i të akuzuarit L.K., në kryerjen e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 424 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, për ti ndihmuar të dyshuarit A.M., për dyshimin e kryer të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, cili ka qenë roli i të akuzuarit L.K. dhe të akuzuarës F.D., në kryerjen veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autorizimet zyrtar, sipas nenit 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, se a janë shkelur procedurat e kërkuara lidhur me rregullat e prokurimit publik, cili ka qenë roli i të akuzuarës M.B., në veprën penale blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara në kryerjen e veprës penale, duke pasur parasysh që e njëjta nga kjo veprë penale ka pranuar automjetin e tipit VWT-roc, me ngjyrë të bardhë, duke pasur apo mos pasur dijeni se vetura në fjalë a është rezultat i veprës penale të kryer nga ana e të akuzuarit L e A.K., rrethanë që duhet vlerësuar pasi që të dëgjohet drejtpërdrejt secili i akuzuar, pastaj të vlerësohet aktgjykimi dënues në veprat penale, sikurse është falsifikimi i dokumenteve, sipas nenit 390 par.1 të KPK, të akuzuar M.B., cili është roli i të akuzuarit A.K., në falsifikimin e dokumentit të institutit mikrobiologjik të IK SHPK, nga kush është lëshuar, kush e ka nënshkruar dhe si i është dërguar B.M.t, i cili të njëjtin raport e ka siguruar me qëllim që ti mundësohet shtyrja e fillimit të ekzekutimit të dënimit, i akuzuari A.K., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par.1 të KPK, duke mundësuar që të dyshuarit A.M., ti lejohet hyrja dhe dalja, përkundër asaj që ka qenë i dyshimtë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, për tu arratisur, sa i përket të akuzuarit L.K., lidhur me veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale, ose detyrimeve financiare, që të gjitha duhet tu nënshtrohen ekspertizave përkatëse, e më pastaj çështjen penale gjykata e shkallës së parë të vlerëson si tërësi dhe të vendos për të njëjtën. Po ashtu të vërtetohet çështja e pagesës së qirasë se si ka shkuar, a ka qenë e siguruar me para në dorë, apo përmes transaksionit nëpërmes të bankës, cili ka qenë raporti i të akuzuarit L, me zyrtarin e prokurimit, dhe si ka shkuar procedura, lidhur me ndërrimin e operatorit ekonomik, për sigurimin e materialeve të blera, për pajisjen e kabinetit të kryesuesit të KPK. Cili është roli i A.Z., A.G., të sqarohen sepse janë me rëndësi për të vërtetuar ekzistimin apo mos ekzistimin e veprave penale.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është vlerësuar nga ana e kolegjit të kësaj gjykate se përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës pedale, se gjendja faktike nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj kolegji gjykuese ka ardhur në përfundim që çështjen penale ta anulon dhe t'ia kthen të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, vlerësimit të provave të cilat procedohen të nxirret vendim përkatës ligjor.

Vendimi lidhur me konfiskimin e sendeve që kanë qenë të përfshira në kryerjen e veprës penale, të vendoset pasi që të vendoset çështja penale.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.400/2023, të datës 17.10. 2023

Bashkëpunëtorja profesionale, Anëtarët e kolegjit,
Albulena Rexha Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga Lubishtani

Beqir Kalludra